



Udhëzues për regjistrim

Instituti AAB i licencuar nga Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar (KKRF), ofron mundësinë e trajnimeve profesionale në këto nivele:

- i** Teknik i Kontabilitetit
- i** Kontabilist i Certifikuar
- i** Auditor i Certifikuar

Kush mund të regjistrohet?

Të drejtë aplikimi, për nivelin Teknik kontabiliteti, kanë të gjithë të interesuarit që kanë përfunduar shkollën e mesme.

Për nivelin Kontabilist i certifikuar dhe Auditor i certifikuar të drejtë aplikimi kanë vetëm ata që posedojnë diplomë universiteti.

Cilat janë kushtet dhe dokumentet e nevojshme për regjistrim?

- i** Plotësimi i aplikacionit për regjistrim (plotësohet në zyrën e regjistrimit)
- i** Të ketë kryer pagesën për aplikim (20€)
- i** Kopja e diplomës së fakultetit ose e shkollës së mesme
- i** Kopja e letërnjoftimit

Si mund të liroheni nga provimet?

Aplikacionit për regjistrim i bashkangjitet një kërkesë në të cilën ju duhet t'i plotësoni me X provimet që kërkonit të liroheni dhe në fund e nënshkruani.

Që të procesohet tutje kërkesa për lirim nga provimet ju duhet ta sjellni në zyrën administrative Certifikatën e Notave origjinale (e nënshkruar dhe e vulosur nga institucioni përkatës). Pas verifikimit të informatave të dhëna, aplikuesi do të njoftohet nëse është liruar apo jo nga provimet.



Si mbahen ligjeratat?

Në Institutin AAB ofrohet mundësia e ndjekjes së ligjeratave fizikisht. Ligjeratat kryesisht mbahen dy herë në javë pasdite (e martë – e enjte) nga ora 17:00. Por, varësisht nevojës dhe kërkesës së anëtarëve të regjistruar mund të ndryshohet orari nga ai i planifikuar.

Kyqja në platformën eStudenti bëhet përmes userit unik i cili krijohet në menyrë automatike në sistem pasi ju ta keni bërë regjistrimin. Të dhënat për qasje dhe Udhezuesi për kyqje në ligjerata online i dergohen kandidatit në email në kohën më të shkurtë të mundshme.

A do të mbahen ligjeratat për të gjitha lëndët njëkohësisht?

Që nga fillimi i funksionimit të IAAB, ligjeratat mbahen lënd pas lëndë.

- i** Shembull: Filloni me ligjerata në F3-Kontabiliteti Financiar, pas përfundimit, organizohet provimi dhe pas nënshtrimit në provim, ju filloni me ligjeratat e lëndës tjetër.

Sa afate të provimeve janë?

Sipas rregullores së IAAB janë gjithsej 4 afate të rregullta të provimeve.

Përveq afateve të rregullta, pas përfundimi të ciklit të ligjeratave (varësisht se cila lëndë është duke u ligjëruar) organizohet provimi për atë lëndë.

Paraqitja e provimeve bëhet brenda afatit të caktuar sipas njoftimit të dërguar në email. Që të mundësohet paraqitja e provimeve duhet dërguar kërkesa me emrin e lëndës që dëshironi ta paraqitni. Paraqitjen e provimeve e bënë administrata në sistem dhe më pas printohet raporti i paraqitjes së provimeve.



Rezultatet e provimeve regjistrohen në sistem dhe dërgohen përmes emailit jo më larg se 30 ditë nga data e mbajtjes së provimit.

Anëtarët kanë të drejtë të bëjnë kërkesë për rishikim të provimit nëse nuk janë të kenaqur me rezultatin apo mendojnë se pritjet e tyre kanë qenë më të mëdha.

Brenda 7 ditëve pas dërgimit të rezultateve të provimeve, anëtarët mund ta bëjnë kërkesën për rishikim të provimit përmes emailit dhe kërkesës duhet të ja bashkangjesin dëshminë e pagesës 20€. Pasi të përfundon afati për pranimin e kërkesave për rishikim, formohet komisioni nga Zyra Ekzekutive për rishikim të provimit. Anëtarëve nuk u lejohe të marrim pjesë në rishikim.

Për çdo ripërsëritje të provimeve, anëtarët obligohen ta kryejnë shumën e pagesës 30€ për nivelet “Teknik i Kontabilitetit” dhe “Kontabilist i Certifikuar” dhe 50€ për nivelin “Auditor i Certifikuar”.

Cilat janë procedurat për certifikim?

Pasi të keni përfunduar provimet e parapara me sukses, anëtari/ja i/e Institutit AAB duhet që ta sjellë në zyrën administrative (perveq dokumenteve te dorezuara me rastin e regjistrimit) si deshmi:

Për certifikim si “Teknik i Kontabilitetit”

- i** Vërtetim për përvojën e punës (jo më pak se një vit; e nënshkruar dhe e vulosur)

Për certifikim si “Kontabilist i Certifikuar”

- i** Dëshmia e përvojën së punës TRE vjeçare duke përfshirë:
 - Kontrata e punës
 - Pasqyra e trustit pensional



- i** Formulari KPP (kërkesat e përvojës praktike) dhe Referenca e bashkangjitur nga Mentori
- i** Kopja e Certifikatës së mentorit (KC ose AC)
- i** EVP-të

Për certifikim si “Auditor i Certifikuar”

- i** Dëshmia e përvojën së punës TRE vjeçare në auditim duke përfshirë:
 - Kontrata e punës
 - Pasqyra e trustit pensional
- i** Formulari KPP (kërkesat e përvojës praktike) dhe Referenca e bashkangjitur nga Mentori Auditor ligjor
- i** Kopja e Certifikatës së mentorit (AC) dhe licenca nga KKRF
- i** EVP-të

Dosja duhet të kompletohet me të gjitha dokumentet e lartpërmendura dhe të verifikohet obligimi financiar i përfunduar sipas kontratës dhe anëtarësia vjetore për të certifikuar:

- i** Teknik i Kontabilitetit - 90€
- i** Kontabilist i Certifikuar - 120€
- i** Auditor i Certifikuar - 150€

Pas kompletimit të dosjes, Zyra Administrative e dërgon për shqyrtim/verifikim në mbledhjen më të afërt të Komitetit të Edukimit. Pas konstatimit se anëtari/ja i plotëson kushtet për certifikim si “Kontabilist i Certifikuar” ose “Auditor i Certifikuar” bëhet njoftimi i kandidatit dhe përgatitet lista për printim të Certifikatës me këto të dhëna:

- i** Emri (emri i babes) mbiemri
- i** Numri i protokolit



- Data (ndërlidhet me numrin vijues në protokol)
- Thirrja e fituar (Teknik i Kontabilitetit, Kontabilist i Certifikuar apo Auditor i Certifikuar)

Lista dërgohet përmes emailit tek personat përgjegjës. Pasi të printohet Certifikata, vuloset dhe nënshkruhet nga Kryetari i Bordit dhe Drejtori Ekzekutiv. Me këtë rast, njoftohet anëtari/ja për tërheqje të Certifikatës në zyrën administrative dhe njëherit bëhet një kopje e Certifikatës e cila mbetet përherë në dosje.

